



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E KAÇANIKUT PËR
VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Univerzum Audit” Sh.p.k. ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga “Univerzum Audit” Sh.p.k. nga Besa Berisha, Udhëheqëse e ekipit si dhe anëtarë Qerim Qerimi, Laura Berisha dhe Eglantina Nikqi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	19
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	28
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	31

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 19.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Kaçanikut.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjendja e pasurive jo financiare nën 1000€ të shpalosura në pasqyrat financiare vjetore në vlerë prej 160,890€ nuk përputhet me vlerën financiare të pasurive jofinanciare në regjistrin e pasurive për diferencën prej 135,951€.

Po ashtu asetet kapitale janë të mbivlerësuara për vlerën prej 16,816€, duke u nënvlersuar asetet nën 1000€ (e-pasuria) si rezultat i keqklasifikimit.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Kryetari i Komunës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës, gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion. Theksimi i çështjes

- Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjendja e pasurive jo financiare nën 1000€ të shpalosura në pasqyrat financiare vjetore në vlerë prej 160,890€ nuk përputhet me vlerën financiare të pasurive jofinanciare në regjistrin e aseteve të Komunës. Vlera e aseteve jofinanciare e regjistruar është 24,938€ gjegjësisht vetëm 15% e vlerës së aseteve jo financiare të raportuara .

- Po ashtu pasuritë kapitale janë mbivlerësuar për vlerën prej 16,816€ e prezantuar në Pasqyrat Financiare si Mobilje, ndërsa për të njejtën vlerë pasuritë nën 1000€ janë nënvlerësuar si rezultat i keqklasifikimit.

Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Kaçanikut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Nëse PFV janë përgaditur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë; dhe
- Nëse Komuna kishte përgaditur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

Përveç çështjeve të theksuara te opinioni të auditimit, PVF-të janë përgaditur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur, përveç atyre të përshkuara tek theksimi i çështjes.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendur jepet rekomandimi:

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për ti përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në shpalosjen e pasurive, regjistrimin e pasurive, dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre. Gjithashtu Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Kaçanikut ka realizuar rreth 94% të të hyrave të parashikuara nga buxheti final për vitin 2018 dhe po ashtu ka shpenzuar 94% të buxhetit final për vitin 2018, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për ti deshifruar vlerat e sakta të llogarive të arkëtueshme duke i përfshi edhe salldot e bartura dhe për të reaguar në inkasimin e tyre në masë të madhe. Gjithashtu, kontrollet kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë menaxhimi i pasurive kapitale, rritja e inkasimit të të hyrave përfshire menaxhimin e pronave komunale .

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	7,737,844	8,294,951	7,811,294	6,713,321	6,651,212
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,013,184	7,214,593	7,157,204	6,119,690	6,004,940
Të bartura nga viti paraprak ²		244,455	169,558	111,877	139,523
Të hyrat vetjake ³	694,915	694,915	374,107	429,039	494,561
Donacionet e brendshme	-	93,699	91,138	52,715	12,188
Donacionet e jashtme dhe huamarrjet	29,745	47,289	19,286	-	-

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 7% gjegjësisht për 557,107€. Kjo rritje është si rezultat i rritjes së ndarjes së mjeteve nga Qeveria në vlerë prej 201,409€, të hyrat e bartura nga viti paraprak për 244,455€, të hyrat nga Donacionet në vlerë prej 93,689€ dhe pranimet nga huamarja janë në vlerë prej 17,543€.

Në vitin 2018, Komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 8,294,951€, ose 1% më tepër krahasuar me vitin 2017 që tregon një trend pozitiv në realizimin e buxhetit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,737,844	8,294,951	7,811,294	6,713,321	6,651,212
Pagat dhe Mëditjet	5,029,014	4,935,424	4,925,423	4,764,651	4,811,841
Mallrat dhe Shërbimet	705,037	921,059	823,679	490,400	504,541
Shërbimet komunale	139,000	137,650	110,318	117,200	116,050
Subvencionet dhe Transferet	204,690	311,360	306,772	161,230	204,270
Investimet Kapitale	1,660,103	1,989,457	1,645,101	1,179,840	1,014,510

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur janë si në vijim:

- Buxheti final për investimet kapitale krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për vlerën 329,354€ ose për 7%. Shtimi i ndarjes buxhetore është bërë nga bartja e të hyrave vetanake nga viti paraprak në vlerën prej 230,913€, pranimet të donacioneve nga Qeveria Zvicerane në vlerë prej 84,138€ dhe rritja nga fondi Huamarja me kërkesë nga MASHT për transfer të mjeteve mes organizatave buxhetore, në vlerë prej 14,1557€. Ndërkaq realizimi i shpenzimeve të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin ishte 82%.

Krahasuar me vitin paraprak nuk ka ndryshime të theksuara në realizimin e buxhetit në këtë kategori, ku rritja e realizimit krahasuar me vitin paraprak është vetëm 3%. Programi për Investime kapitale përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe projekte të reja për vitin aktual. Megjithatë, vonesat në zbatim janë si rezultat i vonesave në iniciimin e procedurave të prokurimit, si dhe jo efikasitetin e mbledhje së të hyrave vetanake të realizuara vetëm 54% në krahasim me mbledhjet e të hyrave të planifikuara.

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar është reduktuar për 93,590€ gjegjësisht për 2%. i cili reduktim është për shkak të Vendimit në Qeverinë e Kosovës nr. 07/08 ku është aprovuar kërkesa e Ministrit të Financave për kursime, ndarje dhe transfere buxhetore ndërmjet kategorisë për paga dhe mëditje dhe kategorive tjera të shpenzimeve. Krahasuar me buxhetin final kjo kategori është realizuar me 99.8%. Kostoja

totale e pagave ka vlerën prej 4,925,423€, me pjesemarrje prej 63% në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme.

- Buxheti final për mallra dhe shërbime është aprovuar për 870,954€. Krahasuar me buxhetin final kjo kategori është realizuar me 89.4%.
- Buxheti për Shërbimet Komunale është aprovuar në vlerë prej 137,649.94€, pra buxheti final ishte reduktuar për 1,350€ krahasuar me atë fillestar. Ky buxhet është shpenzuar vetëm 110,317€ apo 80%, si rezultat i reduktimit të shpenzimeve, kryesisht të energjisë elektrike.
- Në kategorinë e Subvencioneve , buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 106,670€. Rritja e buxhetit për këtë kategori është bërë bazuar në Vendim të Ministrit të Financave për kursime, ndarje dhe transfere buxhetore ndërmjet kategorive të shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2018 sipas kërkesës së Komunës së Kaçanikut 05-Nr 400/01-35818/2018 për mjete shtesë për vitin fiskal 2018, për vlerën prej 65,000€. Po ashtu bazuar në Ligjin Nr.06/L-020 për Buxhetin e RKS-se për vitin 2018 dhe LMFP për lejimin e transferit, janë bërë transfere nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kategorinë e subvencioneve në vlerë prej 25,000€ si dhe bartja e mjeteve vetanake dhe participimet e bujqve për projektet e vitit 2018. Realizimi i kësaj kategorie të shpenzimeve është 98.5%. Shfrytëzuesit më të mëdhenj janë nga sektori i bujqësisë përmes realizimit të një numri të madh të projekteve kryesisht subvencionim apo përkrahje fermerëve dhe bujqve me kultura bujqësore dhe pajisje pune, sektorit i Arsimit dhe Kulturës përmes realizimit të aktiviteteve si në subvencionimin e studentëve, subvencionimit të transportit për nxënësit fillorist, si dhe përkrahja e aktiviteteve sportive, kulturore etj.

Çështja C1⁴-Realizimi i buxhetit

- Gjetja** Ndonëse në nivel të përgjithshëm realizimi i buxhetit ishte 94%, Komuna nuk ka arritur të realizoj buxhetin për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, ku posaçërisht ndryshimi më i theksuar është te kategoria e Investimeve kapitale me një realizim prej 83%, te shpenzimet komunale realizimi i buxhetit ishte 80% dhe te mallrat dhe shërbimet realizimi ishte 89%.
- Rreziku** Planifikimi jo real dhe realizimi i pa mjaftueshëm në kategoritë përkatëse ndikon në mos arritjen e objektivave të Komunës si dhe bartjen e obligimeve nga viti aktual në vitet në vijim.
- Rekomandimi C1** Kryetari duhet të bëjë një vlerësim gjithpërfshirës të shkaqeve të mosrealizimit të buxhetit në disa kategori të caktuara , si dhe të sigurojë një planifikim të drejtë buxhetor krahas projekteve të synuara dhe monitorim të performances buxhetore në baza të rregullta me qëllim realizimit të buxhetit dhe evitimit të keqdeklarimeve.

⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna Kaçanikut në vitin 2018 ishin në vlerë 584,915€ ose për 110,000€ më të ulta se të hyrat e planifikuara. Përqindja e realizimit të të hyrave vetjake është 84% që paraqet një rritje prej 13% krahasuar me vitin 2017. Ato kanë të bëjnë me të hyrat tatimore në vlerë prej 244,907€ të realizuara nga tatimi në pronë në pjesëmarrje prej 42% në të hyrat vetjake, të hyrat jo tatimore në vlerë prej 340,008€ siq janë; nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyra tatimore	272,000	272,000	244,907	233,160	281,390
Te hyra jo tatimore	422,915	422,915	340,008	410,750	351,170
Totali	694,915	694,915	584,915	643,910	632,560

Çështja C2-Niveli i ulët i inkasimit të të hyrave nga qeradhënia e pronave publike

Gjetja

Komuna ka dhënë me qira pronat komunale për shfrytëzim të përkohshëm. Nga të hyrat e planifikuara nga shfrytëzimi i pronës publike në shumë prej 30,000€, të hyrat e raportuara si të inkasuara ishin vetëm 19,521€ apo 65% nga te planifikuarat. E hyra e raportuar nga kjo kategori ndryshon nga të hyrat e evidentuara në libra. Të hyrat nga shkarkimet e klienteve-pagesat janë në vlerë prej 16,682€, 1,500€ janë faljet e borxheve si dhe vlera prej 2,839€ është diferencë e konstatuar si mbivlerësim i të hyrave gjegjesisht mosshkarkim i pagesave të bëra nga klientët.

Po ashtu, nga testet e realizura kemi gjetur se Komuna kishte vazhduar kontratat me qiramarrësit e pronës publike, edhe pse qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet paraprake.

Komuna mbanë evidencë për pronat e dhëna me qira, mirëpo ato nuk janë të plota për të siguruar se të gjitha vlerat janë të llogaritura saktë dhe drejtë. Kësaj evidencë i mungonin informatat për saldon e bartur të borxhit nga viti paraprak si dhe informatat për datën e kontraktuar, përfshirë këtu edhe periudhën e shfrytëzimit të pronës komunale.

Rreziku Mos shkarkimi i klientëve të kësaj kategorie si rezultat i mos koordinimit të zyrtareve përgjegjës dëshmon joprofesionalizëm dhe nivel të ulët të kontrollit e që rezulton me informta të pasakta për të hyrat nga qeradhënia e pronave publike.

Vazhdimi i kontratave ndaj qiramarrësve pa i kryer obligimet paraprake rritë rrezikun e mos inkasimit të të hyrave, si dhe mungesa e monitorimit ndaj shfrytëzuesve të hapësirave publike rritë rrezikun që komuna të ketë humbje financiare. Po ashtu, mos mbajtja e evidencës me informata të plota bën që menaxhmenti të mos ketë informata për vlefshmërinë e kontratave dhe obligimet e qiramarrësve.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të ndërmerri masa në rritjen e përgjegjësive të zyrtarit të shfrytëzimit të pronës publike me zyrtarin e të hyrave të cilët janë të obliguar të bëjnë barazimin e të hyrave në baza mujore. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura. Gjithashtu, të krijoj dhe mbaj një evidencë të qartë dhe të komplettoj atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave nga qiraja të jetë më efikas.

3.1.2 Pagat dhe meditet

Buxheti final për pagat dhe meditet ishte në vlerë prej 4,935,424€. Nga ky buxhetim, realizimi ishte 4,925,423€ ose 99.8%. Pagat dhe shtesat paguhen përmes sistemit të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagesave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin me thesar.

Çështja A1-Mosrespektimi i legjislacionit lidhur me të punësuarit për shërbime të veçanta

Gjetja Gjatë testimit të të punësuarve të ri, kemi konstatuar se raste kur pranimi në punë i të punësuarve për shërbime të veçanta është bërë pa shpallje të konkursit, në dy raste nuk ishin respektuar kërkesat që burojnë nga Ligji Nr. 03/L-212.

Gjatë vitit 2018, në komunë ka pasur të punësuar për shërbime të veçanta për të cilët kohëzgjatja e tyre në punë nuk ishte në përputhje me legjislacionin, ku kohëzgjatja në punë ishte më shumë se 6 muaj.

Bazuar në të gjeturat lidhur kohëzgjatjen në punë kemi konkluduar se Marrëveshjet për shërbime të veçanta nuk përputhen me Legjislacionin, dhe po ashtu edhe për raste të caktuar nuk përputhen kërkesat ligjore lidhur me deklarinimin e pagave.

Rreziku Mosrespektimi i kërkesave ligjore dhe procedurave për rekrutimin e stafit, rrit rrezikun për angazhimin e personave jo adekuat për kryerjen e shërbimeve të kërkuara me konkurs, dhe njëherit paraqet rrezikun e trajtimit jo të barabart për konkurrentët potencial.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se duhet të respektuar të gjitha kërkesat ligjore lidhur me të punësuarit të rregullt dhe për të punësuarit për shërbime të veçanta.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 921,059€ Prej tyre ishin shpenzuar 823,679€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet komunale, derivate dhe lëndë për ngrohje, shërbime kontraktuese, shenzime të mirëmbajtjes dhe riparimeve, si dhe udhëtimeve zyrtare.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 311,360€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 306,772€. Ato kanë të bëjnë me Subvencione për entitete publike dhe Subvencione për entitete jopublike. Realizimi i kësaj kategorie të shpenzimeve është 98.5%. Shfrytëzuesit më të mëdhenj janë nga sektori i bujqësisë, sektorit i Arsimit dhe Kulturës përmes realizimit të aktiviteteve si në subvencionimin e studentëve, subvenconimit të transportit për nxënësit fillorist, përkrahja e aktiviteteve sportive, kulturore etj.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë .

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,989,457€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 1,645,101€. Ato kanë të bëjnë me ndërtesat administrative afariste, objekte shëndetësore, objekte arsimore, ndertimi i rrugëve regjionale, rrugëve lokale, kanalizim, ujësjellës, mirëmbajje investive, makineri etj.

Çështja A2 Mbivlerësimi i investimeve kapitale

Gjetja Nga tri mostrat e testuara të kodit ekonomik 31620, kemi konstatuar se Pasuritë kapitale në PFV janë të mbivlerësuara për vlerën prej 16,816€ si rezultat i keqklasifikimit, e cila vlerë është dashur të regjistrohet në kodin ekonomik 13501-pasuri jofinanciare nën 1000€ e që në këtë rast janë nënvlerësuar për të njëjtën vlerë.

Rreziku Rritja e pasurive kapitale për vlerat e lartëcekura paraqet një keqklasifikim dhe mbivlerësim të pasurive kapitale të Komunës dhe nënvlerësim të pasurive nën 1000€

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj se janë marrë masa konkrete lidhur me klasifikimin e shpenzimeve.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja A3- Prokurimi-aneks kontratat

Gjetja Gjatë verifikimit të dosjeve të prokurimit për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale, të gjitha dosjet e testuara kanë qenë me aneks kontrata kryesisht për vlerën 10% të kontratës.

Rreziku Paraqitja e një dukurie të tillë, pavarësisht që lejohet me ligj, jep të kuptohet se procesi i përgatitjes së kërkesave-specifikimeve teknike në dosjen e tenderit nuk janë planifikuar saktë dhe në mënyrë profesionale ose nuk është bërë përzgjedhja e ofertuesit serioz.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj që procesi i planifikimit të prokurimit të bëhet në mënyrë profesionale, më i saktë dhe përzgjedhja e fituesve të jetë sa më reale.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjatë vitit 2018 Komuna ka bërë një progres të dukshëm në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak. Përkundër progresit, ende nuk është arritur që regjistri kontabël i pasurive të jetë plotësisht i saktë. Mos regjistrimi i pasurisë kapitale sipas kategorisë përkatëse është trajtuar tek pjesa e Theksimit të Çështjes në Opinion, ndërsa në këtë pjesë kemi shpallur dobësitë mbi menaxhimin dhe raportimin e pasurisë më vlerë nën 1,000€.

Çështja B2- Evidenca të mangëta për pasuritë më vlerë nën 1,000€

Gjetja Sipas rregullores mbi pasurinë jo financiare, pasuria nën 1,000€ dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin E-pasuria. Komuna, për pasuritë më vlerë nën 1,000€ në PFV ka shpallur Vlerën prej 160,890€. Nga testimi i blerjeve gjatë vitit 2018, kemi identifikuar se nuk ishin të regjistruar pasuritë jo kapitale të blera në vlerë totale 135,951€. Gjithashtu të pasuritë e regjistruara ka mungesë të informacioneve për data të regjistrimit, numrin e njësisë, vlerat e tyre etj.

Me tutje, Komisioni për inventarizimin vjetor të pasurive kapitale dhe jo kapitale nuk kishte bërë barazimin e regjistrave të inventarizimit me regjistra kontabël të mbajtur nga zyrtaret e pasurive.

Rreziku Dobësitë e identifikuar në regjistrimin e pasurive jo kapitale, shpijnë në menaxhimin joefikas të këtyre pasurive, nënvlerësimin e tyre dhe paraqitje jo të drejtë në raportimin financiar. Mos harmonizimi i regjistrimit të inventarizimit me regjistrat e pasurisë shkakton mangësi në menaxhimin dhe raportimin e saktë të pasurisë, duke rrezikuar njëkohësisht keqpërdorimin apo humbjen e pasurive.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi, si dhe të përcaktojë statusin e pronësisë. Po ashtu gjendja e inventarizuar të krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme të identifikohen dhe më pas të pasqyrohen në regjistrat e pasurive.

3.3 Të arkëtueshmet

Në fund të vitit 2018 të arkëtueshmet kryesisht përbëhen prej llogarive të arketueshme nga tatimi në pronë në vlerë prej 1,095,580€, taksa komunale nga veprimtaria e biznesit prej 252,520€, të arketueshme tjera nga qiraja në vlerë prej 35,120€.

Çështja A4- Harmonizimi i salldove të vitit paraprak me salldot fillestare

Gjetja Llogaritë e arkëtushme nga Shfrytëzimi i pronës publike-Kodi 50405 sipas Auditimit, Salldo e raportuar me 31.12.2017 është në vlerë prej 75,860€, ngarkesa në libra për vitin 2018 në vlerë prej 21,239€, duke zbritur shkarkimet e raportuara me pagesa të klientëve për vitin 2018 në vlerë prej 19,521€ si dhe duke zbritur shumën e stornuar-falur me vendim në shumë prej 1,500€, Salldo e mbetur për raportim për vitin 2018 kapë shumën prej 76,308€ €, derisa është raportuar vetëm 35,120€ Me çka kemi nënvlersim me rastin e të arkëtushmëve të kësaj kategorie në shumën prej 41,188€.

Rreziku Mos bartja e saktë salldove të të arkëtueshmeve nga salldot përmbyllëse në salldot fillestare paraqet rrezik të mbivlerësimit apo nënvlerësimit të disa nga kategoritë e llogarive të arketueshme.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të ndërmerr masa lidhur me sigurimin e një softueri i cili do të mundësonte mbajtjen e saktë të evidencës lidhur me llogaritë e arkëtueshme, kategorizimin e tyre sipas vjetërsisë dhe bartjen e saktë të salldove të tyre në vitin në vijim.

Çështja C3- Mungesa e mekanizmave për inkasimin e të arketueshmeve

Gjetja Përkundër faktit se Komuna ka ndërmarr masa aktive lidhur me inkasimin e llogarive të arkëtueshme, të arkëtueshmet kanë trend rritës krahasuar me vitin paraprak. Rritja e të arketueshmeve ndër vite paraqet jo efikasitet në mbledhjen e borxheve, sidomos borxheve të vjetra të bartura ndër vite .

Rreziku Mos aplikimi i masave konkrete lidhur me inkasimin borxheve e sidomos atyre të bartura ndërvite, ka ndikuar në rritjen e tyre dhe njëkohësisht në mos realizimin e shpenzimeve të cilat ishin planifikuar të financoheshn nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të ndërmerr masa për të shqyrtuar shkaqet për dështim të inkasimeve të llogarive të arkëtueshme dhe të siguroj mekanizma efektiv për mbledhjen e tyre. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura dhe të inicoj proces të rivlerësimit të llogarive të arkëtueshme, ku të gjitha llogarite do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse dhe mundësive reale për inkasimin e tyre, e në raste të caktuara të bëhet provizionimi apo shlyerja e tyre në rast të kategorizimit si borxhe të këqija.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte rreth 17,170€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna. Komuna ka shpalosur edhe detyrimet kontingjente si konteste gjyqësore me vlere prej 61,200 € ku vërehet se ka renje të detyrimeve kontingjente krahasuar me vitin paraprak. Komuna zbaton një proces të rregullt të raportimit të obligimeve. Drejtoritë në përgjithësi janë të vetëdijshme për kërkesat e rregullores për raportim të faturave të papaguara si dhe zyrtari përgjegjës raporton me kohë në Thesar në lidhje me këto llogari.

Rekomandimet

Në nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë ende një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre, por zbatimi i tyre ishte i ulët. Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive të komunës është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Auditimi i këtij viti ka nxjerrë në pah se niveli i rekomandimeve të zbatuara nga viti i kaluar ishte i ulët.

Komuna ka planin zhvillimor nga viti 2011, por ky plan nuk përfshinë llogaritjen e kostove për matjen e rezultateve të objektivave të saj. Plani zhvillimor i komunës me shumë prezanton statistika se sa trendin e zhvillimit të vet komunës. Përveç një plani emergjent, komuna nuk kishte përgatitur

një listë të rreziqeve të cilat janë kërkesë e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Edhe me tutje Komuna nuk posedon planin strategjik kundër korrupsionit.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë të stafit - i cili njëkohësisht është edhe drejtor i njësisë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Çështja C4- Mos zbatueshmëria e rekomandimeve të auditimit të brendshëm

Gjetja Nga gjithsej 20 rekomandime të dhëna, vetëm tetë ishin zbatuar plotësisht, tetë ishin në proces të zbatimit ndërsa kater kanë mbetur të pazbatuara. Periudha të cilën e mbulonin rekomandimet e dhëna, me theks të veçantë për fushën e prokurimit, kryesisht kishte të bëjë me vitin paraprak. Moszbatimi i rekomandimeve të dhëna, tregon një mungesë të vullnetit të menaxhmentit për marrjen e përfitimeve nga auditimi i brendshëm dhe sigurisë mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mosaplikimi i një plani bazuar në rrezik ndikon në mosidentifikimin e dobësive aktuale duke rezultuar me joefikasitet në dhënien e sigurisë ndaj menaxhmentit lidhur me funksionimin e kontrolleve të brendshme. Njëherit, moszbatimi i rekomandimeve nga menaxhmenti redukon efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe përsëritjen e dobësive të identifikuara.

Rekomandimi C4 Kryetari të siguroj se, plani i NjAB-së të zbatojë një qasje ndaj fushave me rrezik duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim, si dhe një fokus më të lartë të menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve, në mënyrë që përfitimet nga auditimi i brendshëm të jenë sa më të larta.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalesje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara ishin të pamjaftueshme dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja B3 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Gjetja Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për investime kapitale dhe mallra e shërbime nuk është shpenzuar. Llogaritë e arkëtueshme nuk ishin trajtuar në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit si dhe nuk ishte bërë regjistrimi i pasurisë e as inventarizimi i plotë i pasurisë. Menaxhmenti po ashtu nuk posedon analiza të rregullta periodike për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta të detajuara për aktivitetet operative.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat e pamjaftueshme të llogaridhënies dhe raportimi i cilësisë jo të duhur reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit, procesi i regjistrimit dhe inventarizimit duhet të përfshinë gjithë pasurinë komunale. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komunës së Kaçanikut ka rezultuar në 14 të gjetura dhe rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu raporti i auditimit ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, gjashtë rekomandime janë zbatuar; katër ishin në proces dhe tri nuk janë adresuar ende, dhe një rekomandim është i mbyllur i pa zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe të merren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë kapitale. E gjithë pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare të blera/ndërtuara duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë. Gjithashtu, Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Edhe në këtë vit ka pasur keqklasifikime dhe menaxhim jo të mirë të pasurisë	E pa zbatuar
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarr një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.	Krahasur me vitin e kaluar ka rritje të realizimit të buxhetit	Pjesërisht e zbatuar
3	Të hyrat Verifikimi i pronave të regjistruara	Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të sigurojë se verifikimi i 1/3-ës së tyre bëhet në baza të rregullta vjetore, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.		E zbatuar
4	Nivel i ulët i inkasimit të të hyrave nga qiradhënia e pronave publike	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura. Gjithashtu, të krijoj dhe mbaj një evidencë të qartë dhe të kompletoj atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave nga qiraja të jetë më efikas. Kryetari duhet të ndërmarrë veprime për ta rishikuar vendimin për mundësinë e pagesave me	Menaxhmenti ka marrë masa dhe janë në proces të përmirësimit të inkasimit	Pjesërisht e zbatuar

5	Të hyrat nga lejet e ndërtimit.	këste, dhe të sigurojë se lejet e ndërtimit lëshohen vetëm pas përfundimit të pagesave të taksave në përputhje me legjislacionin për ndërtimet.		E zbatuar
6	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë se për secilën kontratë të nënshkruar, duhet të ekzistojë menaxheri i kontratës i cili monitoron në vazhdimësi realizimin e kontratës si dhe listën e personave të autorizuar të cilët do të bëjnë pranimin e mallrave dhe shërbimeve të kontraktuara.		E zbatuar
7	Mos ndalja e tatimit në burim dhe kontributeve pensionale	Kryetari duhet të sigurojë se për secilën pagesë, për të angazhuarit përmes shërbimeve të veçanta, mbanë tatimin në burim dhe kontributet në përputhje me kornizën ligjore për tatimin në të ardhurat e personale.		E zbatuar
8	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për secilin projekt/kontratë të lidhur paraprakisht të përgatisë një plan për menaxhimin e kontratave dhe të përcaktojë veprimet që do të merren për të siguruar se për secilën kontratë të nënshkruar ekziston plani për menaxhimin e saj.		E zbatuar
10	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale Evidenca të mangëta për pasuritë më vlerë nën 1,000€	Kryetari duhet të forcojë kontrollet për siguruar evidentimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Në këtë aspekt duhet të sigurojë se pas procesit të inventarizimit gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe më pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive.	Edhe me tutje Komuna ka ngecje në menaxhimin e e-pasurive	E pa zbatuar
11	Të arkëtueshmet Trajtimi i llogarive të arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për inkasimin e të hyrave të saj, përfshirë edhe të arkëtueshmet e mbetura nga vitet paraprake, fillimisht duke i shfrytëzuar të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të komunës, me pas të shfrytëzojë edhe masat tjera ligjore për të siguruar inkasimin e tyre.	Menaxhmenti ka marrë masa dhe janë në proces të permiresimit të inkasimit të llogarive të arkëtueshme	Pjesërisht zbatuar
12	4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas		Rekomandimi i mbyllur i pazbatuar

		afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.		
13	Sistemi i auditimit të brendshëm Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së dhe komiteti i auditimit	Kryetari duhet të siguroj funksionimin e plotë të KA-së, si dhe t'i kushtoj rëndësinë e duhur aktiviteteve të auditimit të brendshëm. Për secilin auditim të bërë nga NJAB-i, duhet të përgatisin planet e veprimit si dhe të monitorojnë ato deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve. Po ashtu KA duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë që devijimet e mundshme të adresohen me kohë.	Përkundër angazhimit të NJAB menxhmenti nuk ka arritur ti zbatoj të gjitha rekomandimet e NJAB	Pjeserisht e zbatuar
14	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe rrezik	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.		E pa zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për ti përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në shpalosjen e pasurive dhe pasurive kapitale dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre Gjithashtu Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmerinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të bëj një vlerësim gjithpërfshirës të shkaqeve të mosrealizimit të buxhetit në disa kategori të caktuara , si dhe të siguroj një planifikim të drejtë buxhetor krahas projekteve të synuara dhe monitorim të performances buxhetore në baza të rregullta me qellim realizimit të buxhetit dhe evitimit të keqdeklarimeve.		

3	Te hyrat	<p>Kryetari duhet të ndërmer masa në rritjen e përgjegjësive të zyrtarit të shfrytëzimit të pronës publike me zyrtarin e të hyrave të cilët janë të obliguar të bëjnë barazimin e të hyrave në baza mujore.</p> <p>Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura. Gjithashtu, të krijoj dhe mbaj një evidencë të qartë dhe të komplettoj atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave nga qiraja të jetë më efikas.</p>
4	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj se duhet të respektohet të gjitha kërkesat ligjore lidhur me të punësuarit të rregullt dhe për të punësuar për shërbime të veçanta.
5	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e kriterëve të përcaktuar në Rregulloren e mbrendshme për sigurimin e kërkesave të mirëarsyetuara dhe ndarjen e subvencioneve duke dëshmuar se janë bazuar në kriteret.
	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë marrë masa konkrete lidhur me klasifikimin e shpenzimeve.
6	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që procesi i planifikimit të prokurimit të bëhet në mënyrë profesionale, më i saktë dhe përzgjedhja e fituesve të jetë sa më reale.
7	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi, si dhe të përcaktoj statusin e pronësisë. Po ashtu gjendja e inventarizuar të krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme të identifikohen dhe më pas të pasqyrohen në regjistrat e pasurive.
8	Te arketueshmet	Kryetari duhet të ndërmer masa për të shqyrtuar shkaqet për dështim të inkasimeve të llogarive të arkëtueshme dhe të siguroj mekanizma efektiv për mbledhjen e tyre. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve,

		kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura dhe të inicioj proces të rivleresimit të llogarive të arkëtueshme, ku të gjitha llogarite do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse dhe mundësive reale për inkasimin e tyre, e në raste të caktuara të bëhet provizionimi apo shlyerja e tyre në rast të kategorizimit si borgje të këqija.
9	Mungesa e mekanizmave për inkasimin e të arketueshmeve	Kryetari të siguroj se, plani i NjAB-së të zbatojë një qasje ndaj fushave me rrezik duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim, si dhe një fokus më të lartë të menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve, në mënyrë që përfitimet nga auditimi i brendshëm të jenë sa më të larta.
10	Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Kryetari të siguroj se, plani i NjAB-së të zbatojë një qasje ndaj fushave me rrezik duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim, si dhe një fokus më të lartë të menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve, në mënyrë që përfitimet nga auditimi i brendshëm të jenë sa më të larta.
11	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit, procesi i regjistrimit dhe inventarizimit duhet të përfshinë gjithë pasurinë komunale. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose

individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një

paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit për vitin 2018 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: "Univerzum Audit" Sh.p.k.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Besim Ilazi

Kryetari i Komunës së Kaçanikut

Data: 28.Maj 2019, Kaçanik

